

VENDIM
Nr. 189, datë 25.3.2021

PËR PËRDORIMIN E FONDIT TË RINDËRTIMIT PËR FINANCIMIN E RIKONSTRUKSIONIT TË NJËSIVE INDIVIDUALE TË BANIMIT DHE NJËSIVE TË BANIMIT NË NDËRTESA (PALLAT), NË BASHKITË TIRANË, DURRËS DHE VORË

Në mbështetje të nenit 100 të Kushtetutës; të neneve 13, shkronja “b”, nënndarja “i”, 25 e 36, të aktit normativ nr. 9, datë 16.12.2019, të Këshillit Ministrave, “Për përballimin e pasojave të fatkeqësisë natyrore”, të miratuar me ligjin nr. 97/2019; të ligjit nr. 9936, datë 26.6.2008, “Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqipërisë”, të ndryshuar, dhe të nenit 7, të ligjit nr. 137/2020, “Për buxhetin e vitit 2021”, të ndryshuar, me propozimin e ministrit të Shtetit për Rindërtimin, Këshilli i Ministrave

VENDOSI:

1. Përdorimin e fondit të rindërtimit, në masën 998 675 000 (nëntëqind e nëntëdhjetë e tetë milionë e gjashtëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë, për financimin e rikonstruksionit të njësive individuale të banimit dhe njësive të banimit në ndërtesa (pallat) për ata individë, të cilët përfitojnë nga grantet e rikonstruksionit, banesat e të cilëve janë klasifikuar si objekte të dëmtuara rëndë apo të dëmtuara lehtë si pasojë e fatkeqësisë natyrore dhe që nuk duhen rindërtuar nga e para, por kanë nevojë për punime rikonstruksioni ose riparime, në bashkitë Tiranë, Durrës dhe Vorë, sipas detajimit të mëposhtëm:

a) Bashkisë Durrës i transferohet fondi në masën 860 700 000 (tetëqind e gjashtëdhjetë milionë e shtatëqind mijë) lekë;

b) Bashkisë Vorë i transferohet fondi në masën 2 000 000 (dy milionë) lekë;

c) Bashkisë Tiranë i transferohet fondi në masën 135 975 000 (njëqind e tridhjetë e pesë milionë e nëntëqind e shtatëdhjetë e pesë mijë) lekë.

2. Efekti financiar, sipas pikës 1, të këtij vendimi, të përballohet nga pjesa e financuar nga shpenzimet e fondit të rindërtimit, miratuar për vitin 2021, dhe t’u transferohet bashkive Tiranë, Durrës dhe Vorë në formën e transfertës së pakushtëzuar.

3. Ngarkohen ministri i Shtetit për Rindërtimin, Ministria e Financave dhe Ekonomisë bashkitë Tiranë, Durrës e Vorë për zbatimin e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë dhe botohet në Fletoren Zyrtare.

ZËVENDËSKRYEMINISTËR
Erion Braçe